Shërbimi i Seancës Plenare

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

**GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE**

**Nr. 1227 prot.** **Tiranë, më 19.03.2026**

**Lënda:** **Për propozimin e kandidaturës për anëtar të Komisionit të Konkurrencës të Autoritetit të Konkurrencës**

**Drejtuar:** **Zotit Niko PELESHI**
**KRYETAR I KUVENDIT**

*I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,*

Kuvendi i Shqipërisë në përputhje me përcaktimet e neneve 20, 21 dhe 22, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, ka zgjedhur me vendimin e Kuvendit nr. 29, datë 8.03.2021, z. Denar Biba në detyrën e anëtarit të Komisionit Konkurrencës të Autoritetit të Konkurrencës.

Në zbatim të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit dhe neneve të sipërcituara, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat me vendimin nr. 2/2026, vendosi miratimin e procedurës paraprake të përzgjedhjes së anëtarit të Komisionit të Konkurrencës të Autoritetit të Konkurrencës dhe publikoi në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë njoftimin zyrtar.

Sipas nenit 21, pika 3 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, anëtarët e Komisionit zgjidhen nga Kuvendi, me kandidatura alternative.

Për sa më lart, ne një grup deputetësh, i paraqesim Kuvendit për shqyrtim dhe miratim kandidaturat alternative për anëtar të Komisionit të Konkurrencës të Autoritetit të Konkurrencës, si më poshtë:

1. Z. Denar Biba
2. Z. Eldian Balla

*Duke ju falenderuar.*

**DEPUTETËT**

1. Taulant Balla

2. Milva Ekonomi

3. Erion Malaj

4. Ilva Gjuzi

5. Antoneta Dhima

6. Zegjine Çaushi

7. Ana Nako

8. Damian Gjiknuri

9. Alma Selami

10. Bledi Çomo

11. Elton Korreshi

12. Besa Spahiu

13. Onid Bejleri

14. Asllan Karaliu

15. Gerdi Lokollari

16. Etleva Budimi

17. Admir Kadeli

18. Briseida Çakoni

19. EDUARD SHALSI

20. [illegible] Pendavinji

21. Erjona Ismaili

22. Agron Gaxho

23. Ardit Bido

24. Olsi Komici

25. Marjana Koçelari

26. SAIMIR HASALLA

27. Iris Luarasi

28. Erjo Mile

29. Pirro VENGU

30. Adri Dose